

Arrestohet një person në Shtime, iu gjeten armë në shtëpi



28/08/2024 21:03



Njësia e Hetimeve të stacionit në Shtime, e mbështetur edhe nga policët e rendit, në bazë të një urdhërese të Gjykatës Themelore të Ferizajt, sot ka realizuar një kontroll në fshatin Petrovë të Shtimes dhe në shtëpinë e të dyshuarit R.R (M/K) i moshës 28 vjeçar, kanë gjetur dy armë të zjarrit : një pushkë automatike dhe një pistoletë.

Sipas policisë, kontrollit të shtëpisë së të dyshuarit R.R i ka paraprirë një hetim disa ditësh nga hetuesit policorë, pasi i dyshuari kishte shtënë me pistoletë në ajër, në një fushë në rajonin Shtimes.

“I dyshuari është shoqëruar në stacionin e policisë në Shtime dhe pas intervistimit nga hetuesit policorë, me vendim të prokurorit të shtetit është ndaluar në mbajtje për 48 orë, për procedura tjera hetimore, ndërsa si provë materiale janë sekuestruar dy armët e zjarrit”, thuhet në komunikatë.

Më tej thuhet se rasti është cilësuar “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “ Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim i paautorizuar i armëve në Shtime.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by laptopmedia




Artikuj të ngjashëm



August 29, 2024
Rizvanolli dhe Krasniqi në veri për hapjen e Postës së Kosovës:...



August 29, 2024
Antidroga në aksion -Konfiskon mbi 40 paketime me substancë narkotike në...




August 29, 2024
FAST Kosova arreston një person për trafikim me narkotikë në Mitrovicë,...



August 29, 2024
Gjendet një granatë dorë në Tërpezë të Malishevës, FSK ka bërë...



August 29, 2024
Dhunohet një femër në një hotel në Graçanicë



August 29, 2024
Sulmuan ekipin mjekësor në Prishtinë, arrestohen dy persona

Other Links